REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
SHËRBIMI ADMINISTRATIV

Analizë mbi zbatimin e buxhetit për vitin 2025

Me mbylljen e vitit buxhetor 2025, dhe përfundimi të rakordimeve me buxhetin e shtetit, për buxhetin e realizuar, në zbatim të Rregullores së Kuvendit dhe udhëzimeve të zbatimit të buxhetit, ju paraqesim një raport mbi realizimin e buxhetit të vitit 2025.

Buxheti i vitit 2025 është miratuar me ligjin nr. 115/2024, "Për buxhetin e vitit 2025" dhe ka mbështetur arritjen e qëllimit të politikave përkatëse, për dy programet buxhetore:

- programi buxhetor të "Veprimtarisë legjislative, diplomacisë dhe kontrollit parlamentar";
- programi mbështetës "Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi".

Objektivat kryesore për procesin e realizimit të buxhetit synojnë:

- Krijimin e një lidhjeje të drejtpërdrejtë ndërmjet prioriteteve institucionale dhe prioriteteve në shpenzime, me qëllim shpërndarjen efektive të burimeve në dispozicion;
- Inkurajimin e efektivitetit, efiçencës dhe ekonomisë në kryerjen e shpenzimeve publike dhe alokimin e burimeve;
- Forcimin e disiplinës fiskale duke mundësuar që shpenzimet publike të planifikohen brenda një kuadri realist makroekonomik dhe fiskal.
- Zgjerimin e vizionit të procesit të buxhetimit, duke synuar që programet e shpenzimeve të planifikohen në një periudhë afatmesme (3-vjeçare).

Ecuria e planeve buxhetore në vite, paraqten në grafikun nr.1, si më poshtë:

Grafiku nr.1



Grafiku nr.1, paraqet në mënyrë krahasimore, planet vjetore në vite, sipas ligjit të buxhetit dhe përbri këtij, planin në fund të secilit vit, që reflekton ndryshimet me akte normative, me kërkesën e Kuvendit për të kthyer fondet që rezultojnë të lira.

Nga grafiku shihet që planet buxhetore kanë qënë në rritje nga viti në vit.

Scanned with CamScanner

Duhet theksuar që Kuvendi është njësi shpenzuese, që nuk siguron të ardhura, dhe veprimtaria e tij, financohet vetëm nga buxheti i shtetit.

Plani buxhetor i Kuvendit për vitin 2025, sipas ligjit të sipërcituar, ishte 0.33 % e shpenzimeve të planifikuara për buxhetin e shtetit, për vitin 2025

Tabela e mëposhtme paraqet planin buxhetor në fillim të vitit 2025, planin në fund të vitit, i ndryshuar me akte normative dhe kërkesa të Kuvendit, si dhe realizimin faktik vjetor:

Tabela nr 1. Plani buxhetor i vitit 2025 dhe realizimi faktik:

në mijë lekë

Nr	Emërtimi shpenzimeve	Plani buxhetor sipas ligjit vjetor të buxhetit	Plani buxhetor me ndryshimet gjatë vitit buxhetor 2025	Realizimi faktik i buxhetit të vitit 2025	% e realizimit
a	b	1	2	3	4=3/2*100
1	Shpenzime për paga	1.116.863	1.077.263	1.049.839	97.45 %
2	Shpenzime për kontribute të sigurimeve	146.758	135.758	131.926	97.17 %
3	Shpenzime të tjera operative (mallra/shërbime)	635.456	616.656	453.570	73.55 %
4	Tranferta të huaja (kuota parlamentare)	15.090	15.090	10.228	67.79 %
5	Transferta individuale (fond i veçantë, rimbursime telefonie dhe pagesa për lënie funksioni)	0	55.326	54.260	98.07 %
6	Shpenzime kapitale	137.000	92.000	81.261	88.32 %
	Totali	**2.051.167**	**1.900.093**	**1.781.084**	**93.73 %**

Në tabelë paraqiten grup shpenzimet kryesore, të cilat në ligjin për buxhetin identifikohen në llogari 3 shifrore dhe realizimi në përqindje për secilën llogari, kundrejt planit të ndryshuar gjatë vitit.

Pesha specifike e grupshpenzimeve kryesore, në totalin e buxhetit vjetor të Kuvendit, paraqitet në grafikun nr.2, si më poshtë:

Grafiku nr.2



Grafiku nr.2 paraqet peshën specifike të shpenzimeve kryesore si pagat dhe kontributet, që zënë 66% të totalit vjetor të buxhetit, 26 % janë shpenzimet për aktivitete, blerje materiale, mirëmbajtje zyra, sisteme elektronike, shpenzime transporti etj, të cilat planifikohen dhe detajohen hollësisht në regjistrin e prokurimit. Ky regjistër publikohet në Agjencinë

Scanned with CamScanner

e Prokurimit Publik, pasi merr konfirmim nga Dega e Thesarit;
investimet zënë 5 %, ndërsa pagesat e kuotave parlamentare, janë vetëm 1 % e planit vjetor.

Grafiku nr.3



Grafiku nr.3 paraqet peshën specifike të planit buxhetor të secilit program, në totalin vjetor të Kuvendit.
Buxheti i programit legjislativ, që zë peshën specifike më të madhe, përfshin shpenzimet për paga e kontribute të deputetëve dhe stafit politik; përfitimet financiare të deputetëve që burojnë nga statusi i deputetit; shpenzime të udhëtimeve jashtë shteti, organizime të konferencave, të pritje e përcjellje delegacione, pagesa të përkthyesve dhe ekspertëve të jashtëm, në rastet e nevojave të komisioneve parlamentare dhe atyre të posaçme e hetimore, honorare për mbledhjet e komisioneve.
Sipas ligjit organik të buxhetit, rishpërndarja e fondeve nga njëri program buxhetor në tjetrin, në rast nevoje, bëhet vetëm me vendim të Këshillit të Ministrave.

NUMRI I PUNONJËSVE

Ligji "Për buxhetin e vitit 2025" ka miratuar për Kuvendin numrin 465 të punonjësve (staf politik, përfshirë deputetët si dhe stafin administrativ) nga të cilët 408, ishte numri faktik në mbyllje të vitit dhe me vendime të Këshillit të Ministrave janë miratuar 19 punonjës me kontratë të përkohshme, por 17 ishte numri faktik në mbyllje të vitit.

Përbërja e burimeve njerëzore (sipas numrit faktik të vitit 2025) është: deputetët zënë 32 % të numrit faktik për vitin 2025, stafi politik 14 %, nëpunësit civilë 44% dhe punonjësit mbështetës zënë 10 % të totalit të numrit faktik.
Numri faktik, i cili rezulton më i ulët se numri i planifikuar për vitin 2025, argumentohet me:
-Numri i deputetëve planifikohet 140, por nuk plotësohet, për shkak të funksioneve në qeveri të disa deputetëve (numri faktik 129);
- stafi politik jo i plotësuar;
-rekrutimi i vendeve vakante për stafin administrativ, në proces.

SHPENZIMET PËR PAGAT DHE KONTRIBUTET

Buxheti i viti 2025 në këtë zë është realizuar në masën 97.36 %, ndaj planit të ndryshuar.

Scanned with CamScanner

Ndryshimet në planin buxhetor gjatë vitit, konsistojnë në kthimin e fondeve të lira, të cilat rezultojnë nga vendet vakante, të paplotësuara. Gjatë vitit buxhetor, bëhen analiza dhe kthehen në buxhet fondet që rezultojnë të lira.

Grafiku nr.4



Grafiku paraqet realizimin e fondit të pagave në vite, duke pasqyruar trendin e rritjes, që vjen nga rritja e numrit të punonjësve, por dhe nga politikat e rritjes së pagave.

SHPENZIMET OPERATIVE PËR BLERJE MALLRA E SHËRBIME (602)

Me qëllim menaxhimin efiçient të fondeve buxhetore dhe parandalimin e krijimit të detyrimeve të papaguara në kohë, në zbatim të ligjit vjetor të buxhetit dhe udhëzimeve për zbatimin e tij, janë bërë detajimet e fondeve vjetore sipas kërkesave të drejtorive dhe konform aktiviteteve vjetore që ato kanë planifikuar të realizojnë.

Ky grup shpenzimesh është realizuar në masën afro 73.55 të planit vjetor 2025, të ndryshuar.

Janë një sërë grupshpenzimesh që përbëjnë këtë grup shpenzimesh të marrë në analizë, dhe identifikohen me një numër llogarie shtatëshifrore, përveç emërtimit.

- Shpenzimet që zënë peshën specifike më të madhe në këtë grup janë: përfitimet financiare të anëtarëve të parlamentit, që jane sanksionuar në Statusin e Deputetit dhe Vendimin e Kuvendit 114/2014 "Për trajtimin e deputetëve" (rimbursime për shpenzime telefonie, karburanti, dieta brenda vendi, honorare për pjesëmarrje në mbledhjet e komisioneve parlamentare dhe mbulimin e qirasë së banimit).

Realizimi faktik i tyre është 200 milion lekë dhe 44.2 % e totalit faktik të këtij grupi shpenzimesh;

- Shpenzimet për udhëtime jashtë shteti (bileta, dieta dhe akomodim), realizuar 60 milion lekë për vitin 2025, janë një nëngrup tjetër i konsiderueshëm. Gjatë vitit 2025 janë lëshuar 116 urdhra udhëtimi jashtë shteti, për 437 pjesëmarrës në aktivitete jashtë vendi (deputetë dhe staf politik e administrative), nga të cilët 186 deputetë dhe 60 staf politik;
- shpenzime pritje e përcjellje delegacione, realizuar 8 milion lekë;
- pagesa për honorare ekspertë të jashtëm në komisione hetimore apo të posaçme, 11 milion lekë;

Scanned with CamScanner

- pagesa për ekzekutim të vendimeve gjyqsore, në total 16 milion lekë, nga të cilët për shkarkime nga puna në vitin 2013-2014 janë paguar 14.5 milion lekë dhe për deputetë, 1,5 milion lekë;
- shpenzime për mirëmbajtje të sistemeve elektronike dhe pajisjeve të zyrave, realizuar përkatësisht 49 milion lekë;
- shpenzime për mirëmbajtje zyra, pajisje ngrohje ftohje, ashensorë, motogjeneratorë etj 14 milion lekë;
- shpenzimet utilitare (energji elektrike, ujë dhe telefon), realizuar 10 milion lekë;
- shpenzime transporti 8 milion lekë ;
- blerje kancelari, materiale shtypshronje, materiale pastrimi, hidraulike, elektrike, marangozi dhe lule natyrale, shpenzuar 10 milion lekë;

Shpenzimet për kuotat parlamentare

Edhe për vitin 2025, janë paguar detyrimet vjetore për kuotat parlamentare në ato organizata ku bën pjesë dhe Kuvendi i Shqipërisë si OSBE, IPU, NATO, PABSEC, PAM si dhe abonimi online IFLA.
Pagesa e kuotave bëhet pas njoftimit për detyrimin nga organizatat përkatëse.
Realizimi vjetor paraqitet 68.2%.
Realizimi rezulton i ulët, për shkak se pagesat bëhen në valutë (kryesisht euro), dhe kurset e këmbimit valutor kanë qënë në nivele të ulëta, duke u shpenzuar më pak se plani.

Investime Kapitale

Shpenzimet kapitale të vitit 2025 janë realizuar 88.32 % ndaj planit të ndryshuar.

Realizimi i këtyre shpenzimeve konsiston në:

1. realizimin e ***sistemit të planifikuar, për ndërveprimin me publikun OSHC, OJF, palë interesi dhe lobiste" në vlerë 5.6 milion lekë***. Ky projekt synon digjitalizimin e regjistrave dhe proceseve manuale aktuale, që sjellin vështirësi dhe vonesa në kthimin e përgjigjeve, palëve lobiste, shoqërisë civile etj.;

2.***transkriptimi i të dhënave audio video të Kuvendit bazuar ne inteligjencën artificiale***, nje pjesë e të cilit do të paguhet me fondet e vitit 2026. Për vitin 2025 është paguar 30 milion lekë. Nëpërmjet këtij projekti, Kuvendi synon të realizojë transkriptimin automatik të seancave plenare, mbledhjeve të komisioneve parlamentare të përhershme, mbledhjeve të komisioneve të veçanta, aktiviteteve të ndrysme etj, të cilat çojnë përpara agjendën e furnizimit të transparencës legjislative të institucionit nëpërmjet teknologjive të informacionit.

3.krijimin e një ***aplikacion i ri, me emërtimin "Kuvendi i Shqipërisë", me vlerë 1.2 milion lekë***. Në buxhetin e vitit 2025, ishte parashikuar upgrade i aplikacionit ekzistues, me të njëjtin emërtim, por sipas argumentave të shtruara nga shërbimi i teknollogjisë infomative në Kuvend, aplikacioni ekzistues nuk i përgjigjej kushteve të kohës, dhe duhej një aplikacion i ri;

Scanned with CamScanner

4.***blerjen e autoveturave me vlerë 14.5 milion lekë***. Këto dy autovetura do të zëvendësojnë autoveturat ekzistuese me gjendje amortizimi fizik dhe kontabël shumë të lartë, konkretisht dy autoveturat ekzistuese me vit prodhimi 2013 dhe 2019;

5. ***blerje pajisje dhe arredime zyrash, 23 milion lekë***, në të cilat përfshihen tapete ceremoniale, ndriçues për sallat e komisioneve parlamentare dhe arredim i zyrave të komisioneve të reja të përhershme, që filluan punën në shtator 2025.

6.**pagesë e TVSH-së bazuar në projektin për "Mbështetjen e Kuvendit dhe edukimit qytetar (PACEP II)",** ***5.4 milion lekë***, si detyrim i Kuvendit për rimburësimin e pagesave të TVSH-së ndaj donatorëve dhe partnerëve implementues.

Scanned with CamScanner